

Dokumente që përmbajnë tregues të performancës së AP

PASQYRA E LËNDËS

- Raport vjetor janar – gusht 2023
- Analiza vjetore e QBZ për vitin 2022
- Raport monitorimi i planit të integritetit

RAPORT PËRMBLEDHËS MBI VEPRIMTARINË E QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE PËR PERIUDHWN JANAR-GUSHT 2023

Qendra e Botimeve Zyrtare, në veprimtarinë e saj , bazuar në Ligjin nr.78/2014 datë 14.10.2014 , ka raportuar pranë Ministrisë së Drejtësisë Përparësitë, Objektivat, Treguesit 2023 si planifikim për tu realizuar gjatë vitit.

Për periudhën janar-gusht 2023 ju raportojmë realizimin e treguesve të objektivave të QBZ, si më poshtë vijon:

Sektori i botimit të Fletores Zyrtare

Sektori i Botimit të Fletores Zyrtare ka realizuar botimin në letër dhe në variant elektronik të 127 Fletoreve Zyrtare të vitit 2023, në numër total prej 15163 faqesh.

Tabela 1. Përmbledhëse e botimeve të Fletores Zyrtare Janar – Gusht 2023

Aktet e botuara në Fletore Zyrtare për vitin 2023	Fletorja Zyrtare 2023 1– 127
Ligje	84
Vendime të Kuvendit	52
Rezoluta të Kuvendit	26
Dekrete	148
Akte normative	4
Vendime të Këshillit të Ministrave	403
Urdhra të Kryeministrit	1
Udhëzime dhe urdhra të Ministrave	207
Vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut	21
Vendime të Gjykatës Kushtetuese	50
Vendime të Gjykatës Lartë	3
Vendime të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike	243
Vendime të Autoritetit të Mediave Audiovizive	1
Vendime të Entit Rregullator të Ujit	15
Vendime dhe udhëzime të Bankës së Shqipërisë	12
Vendime dhe udhëzime të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	7
Vendime dhe urdhra të Këshillit të Lartë të Prokurorisë	1
Urdhra të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	2
Vendime të Komisionit të Ndihmës Shtetërore	1
Vendime të Këshillit të Lartë të Arkivave	8
Njoftime të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme	19
Urdhra të Inspektoratit Qendror	1
Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	7
Udhëzime të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë	1

Urdhra i Komisionit të Posaçëm të Apelimit	8
Vendime të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit	12
Vendime dhe urdhra të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit	23
Kërkesa për shpronësim	53
Vendime dhe kërkesa të gjykatave, për shpallje të zhdukur dhe të vdekur	30
TOTALI	1443

Të gjitha aktet janë botuar brenda afatit 10-ditor, parashikuar në nenin 10 të ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”.

Sektori i botimit të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare

Gjatë periudhës janar-gusht 2023, sektori i Botimit të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare ka realizuar botimin në letër dhe variant elektronik të **30** numrave të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare.

Të gjitha aktet janë botuar brenda afatit 10 ditore, parashikuar në nenin 10, të ligjit nr. 78/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”.

Janë botuar **61** akte, numri total i faqeve është **608** me tirazh 500 copë.

Sektori i Arkivit Elektronik

Gjatë periudhës Janar gusht 2023 ka realizuar proceset e punës si më poshtë:

Për periudhën Janar gusht 2023 Qendra e Botimeve Zyrtare ka realizuar dhe ka publikuar në variant elektronik **1443** akte të botueshme.

Gjatë kësaj periudhe janë përditësuar **279** akte si ligje, vendime të Këshillit të Ministrave dhe akte të tjera, si: urdhra, udhëzime të ministrave etj nga të cilat **17** janë akte të shfuqizuara.

Në përfundim të procesit të përditësimit, versionet e përditësuara të akteve janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të institucionit.

Jane realizuar **6** tituj botimesh, “Përmbledhëse legjislacioni për personat me aftësi të kufizuara”, “Përmbledhëse legjislacioni për pronësinë industriale”, “Përmbledhëse legjislacioni për të miturit”, “Përmbledhëse legjislacioni për të huajt”, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Kodi Rrugor

Shërbimi i informacionit ligjor për publikun

Në përmbushje të detyrës së shërbimit të Informacionit Ligjor për Publikun gjatë periudhës Janar gusht 2023 janë realizuar detyrat e mëposhtme:

Mbajtja e korrespondencës me institucionet shtetërore në lidhje me informacionet e publikimit të akteve në Fletoren Zyrtare dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

Ndjekja e punës me kërkesat e qytetarëve për informacione të ndryshme ligjore dhe kthimi i përgjigjeve brenda afateve ligjore, gjithsej **82 përgjigje të kërkesave me e-mail dhe 6 në formë shkresore.**

Pritja e publikut në mjediset e Qendrës së Botimeve Zyrtare, janë trajtuar **gjithsej 117 raste** të kërkesave të ndryshme për informacion për akte ligjore.

Sektori i Financës

Në zbatim të ligjit 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Qendrës së Botimeve Zyrtare i janë akorduar fonde buxhetore në masën 61,600,000 lekë dhe me shkresë të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr.12310/1, datë 24.07.2023 është miratuar akordimi i fondeve shtesë si rezultat i efekteve financiare që rrjedhin nga VKM 325, 326 në masën 4 146 000 lekë.

Gjatë periudhës 8 mujore ka patur 2 rialokime fondesh:

- çelje të fondeve në artikullin 606 në masën 124 000 lekë
- shtesë fondesh në artikullin 600999 për mbulimin e efekteve financiare nga rritja e nivelit të pagave sipas VKM 325 dhe 326 në masen 4 146 000 lekë.

Realizimi 8 mujor i buxhetit është në masën 69.27 %.

Kjo vjen si rezultat:

- Mos realizimit të fondeve buxhetore të planifikuar në zërin “Investime”, pasi procedura e prokurimit që kryhet nga AKSHI për blerje pajisje elektronike/informatike, nuk ka përfunduar ende.
- Janë ende në vijim kontratat për të cilat janë obliguar dhe fondet buxhetore në artikullin 602.

Prokurimi publik

Gjatë periudhës Janar - Gusht 2023 janë parashikuar 6 Procedura Prokurimi të cilat janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr	Objekti i prokurimit	Lloji i perocedurës(minikontrate ne kuadër te marreveshjes kuadër)	Data e zhvillimit të procedurës	Emri I operatorit ekonomik të shpallur fitues dhe NIUS	Vlera e kontrates së nënshkruar LEK
1	Botime speciale dhe shtypje kapakësh për vitin 2023	prokurim me vlere të vogël	13.4.2023	Milenium I RI K31802035S	259,210
2	Blerje materiale pastrimi 2023	Blerje nën 100 mijë lekë	19.4.2023	TOTAL CLEANING L42307019E	98,678
3	Dezinfektim ambjentesh	Blerje nën 100 mijë lekë	20.4.2023	Aldi Bixhaka L91505027R	33,333
		marrëveshje kuadër	19.1.2023	INFOSOFT	598 384,

4	Kancelari, Letër 2021 Blerje leter			OFFICE J62496002Q	25
5	Shpenzime transporti- Karrotrec	Blerje nën 100 mijë lekë	5.5.2023	Aldo Gaz L52318005V	3,333
6	Blerje Bojra printeri	prokurim me vlere të vogël	25.5.2023	Adenis Kastrati L51611004I	91,917

Mirëmbajtja e infrastrukturës TIK të institucionit

Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit dhe e Komunikimit (TIK), është një komponent shumë i rëndësishëm për institucionin, por në këtë periudhë ka patur problematika. Këto kanë sjellë probleme në disa aspekte të punës si me serverin në ambjentet e QBZ, pasi të dhënat e dixhitalizuara ndër vite janë të pa aksesueshme nga ana jonë për tju vënë në dispozicion publikut në realizim të drejtës së informimit dhe problematika në disa raste në publikimin e akteve dhe të Fletore Zyrtare.

Synohet në bashkëpunim me Akshi për popullimin e faqes me akte të arkivit historik si dhe ndërlidhjen e sistemeve.

Në këtë raportim, u pasqyrohen progreset dhe problematikat gjatë aktivitetit të punës për çdo sektor.

ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE PËR VITIN 2022

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Qendra e Botimeve Zyrtare është krijuar për herë të parë në vitin 1999, me ligjin nr. 8502, datë 30.6.1999, “Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”, me nismën e Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian, me qëllim rritjen e transparencës së normave ligjore, si një nga hapat shumë të rëndësishëm në krijimin e shtetit ligjor dhe në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Sot, veprimtaria e Qendrës së Botimeve Zyrtare mbështetet në ligjin nr. 78/2014, “Për Qendrën e Botimeve Zyrtare”, dhe qëllimi kryesor i saj është: *Bërja e njohur botërisht, në formë të shkruar dhe elektronike, e akteve të botueshme në Fletore Zyrtare, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe përditësimi i tyre.*

MISIONI

Qendra e Botimeve Zyrtare të Shqipërisë, me anë të botimeve, publikimeve dhe veprimtarive të tjera, synon njohjen nga organet shtetërore dhe nga institucionet e tjera të administratës publike, nga personat fizikë dhe juridikë, të ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të akteve normative të Këshillit të Ministrave, të ministrive dhe të organeve drejtuese

të institucioneve të tjera qendrore, të akteve të tjera të rëndësishme të nxjerra nga institucionet shtetërore, në shërbim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të tyre, të forcimit të rendit juridik dhe kushtetues.

VIZIONI I QENDRËS

Qendra e Botimeve Zyrtare është institucion në shërbim të publikut të gjerë, me qëllim që t'u ofrojë atyre informacion mbi rrugën më të shkurtër drejt së drejtës, duke krijuar një akses maksimal në normat juridike, me qëllim njohjen dhe zbatimin sa më të gjerë të tyre, për krijimin e një shteti ligjor dhe një shoqërie demokratike të bazuar në të drejtën. Pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, çdo subjekt mund të njihet, drejtpërdrejt dhe pa shpërblim, me përmbajtjen e akteve të botuara.

KUADRI LIGJOR

Aktualisht, Qendra e Botimeve Zyrtare ushtron veprimtarinë mbështetur në ligjin nr. 78/2014, është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe funksionon në bazë dhe në zbatim të bazës ligjore, si më poshtë:

- Ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 284, datë 14.5.2014, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe për funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave elektronike të akteve”;
- Urdhrit të Kryeministrit nr. 82, datë 17.6.2015, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve Zyrtare”, si dhe ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 214, datë 11.3.2015, “Për përcaktimin e afateve dhe të masave që duhet të merren, në lidhje me ankesat për gabimet dhe defektet e botimit dhe të publikimit”;
- Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 11.3.2015, “Për mënyrën, format dhe procedurën e dërgimit të tekstit të akteve të botueshme në Fletoren Zyrtare, si dhe për formatin e shkruar në letër dhe formatin elektronik të tyre”;
- Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 11.3.2015, “Për formatin, kriteret teknike, procedurat e përgatitjes, ditët e botimit, tirazhin e kopjeve, mënyrën e vënies në qarkullim dhe shpërndarjen e Buletinit të Njoftimeve Zyrtare”;
- Udhëzimit të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Financave nr. 8451/4, datë 15.1.2015, “Për caktimin e çmimit dhe të tarifave të botimeve të Qendrës së Botimeve Zyrtare, si dhe institucionet që përfitojnë falas kopje të botuara të Fletores Zyrtare”;
- Urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 607/1, datë 10.11.2014, “Për kriteret dhe mënyrën e botimit të Fletores Zyrtare”;
- Urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 607, datë 10.11.2014, “Për krijimin e regjistrit shtetëror të akteve”;
- Urdhrit të ministrit nr. 7717/1, datë 10.10.2018, “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe për funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”.

PRODUKTET E QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

- *Fletorja Zyrtare*;
- *Buletini i Njoftimeve Zyrtare*;
- *Kode*;
- *Përmbledhëse legjislacioni sipas fushave*;
- *Botimi elektronik i Fletores Zyrtare, i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, i kodeve dhe i përmbledhësve të legjislacionit*;
- *Publikimi online në faqen e web-it të legjislacionit të përditësuar*.

OBJEKTIVA PËR T’U ARRITUR

- Pasurimi i arkivit elektronik me aktet historike 1912–1989;
- Përmirësimi i sistemit të publikimit *online*, në përputhje me zhvillimet e ardhshme teknike;
- Përmirësimi i performancës të QBZ-së mbi informacionin ligjor të akteve dhe shërbimet e reja;
- Identifikimi, analizimi dhe propozimi i amendimit të kuadrit rregullator, që synojnë përmirësimin e standardeve të shërbimeve ekzistuese të QBZ-së dhe të reja *online*.

ORGANIZIMI I QBZ-së

Struktura e Qendrës së Botimeve Zyrtare është e organizuar në mbështetje të urdhrit të Kryeministrit nr. 82, datë 17.6.2015, “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Qendrës së Botimeve Zyrtare”, si dhe të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

STRUKTURA E QBZ-së:

- I. Drejtori;
- II. Kryeredaktori;
- III. Sektori i Fletores Zyrtare;
- IV. Sektori i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare;
- V. Sektori i Arkivit Elektronik;
- VI. Sektori i Financës dhe i Shërbimeve;
- VII. Sektori i Shtypshkronjës.

Më poshtë kemi paraqitur punën e realizuar nga Qendra e Botimeve Zyrtare për periudhën janar–dhjetor 2022.

1. SEKTORI I BOTIMIT TË FLETORES ZYRTARE

Sektori i Botimit të Fletores Zyrtare ka realizuar botimin në letër dhe në variant elektronik të **179** Fletoreve Zyrtare të vitit 2022, në numër total prej 23335 faqesh.

Tabela 1. Përmbledhëse e botimeve të Fletores Zyrtare 2021–2022

Aktet e botuara në Fletore Zyrtare për vitin 2022	Fletorja Zyrtare 2022 1–179
Ligje	89
Vendime të Kuvendit	85
Rezoluta të Kuvendit	26
Dekrete	115
Akte normative	19
Vendime të Këshillit të Ministrave	754
Urdhra të Kryeministrit	2
Udhëzime dhe urdhra të Ministrave	373
Vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut	21
Vendime të Gjykatës Kushtetuese	41
Vendime të Gjykatës Lartë	6
Vendime të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike	295
Vendime të Autoritetit të Mediave Audiovizive	1
Vendime të Entit Rregullator të Ujit	40
Vendime dhe udhëzime të Bankës së Shqipërisë	21
Vendime dhe udhëzime të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	3


Urdhër i Komisionerit të Prokurimit Publik	2
Vendime dhe urdhra të Këshillit të Lartë të Prokurorisë	10
Urdhër i Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	1
Vendime të Komisionit të Ndhmës Shtetërore	7
Vendime të Këshillit të Lartë të Arkivave	14
Njoftime të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme	31
Urdhra të Inspektoratit Qendror	3
Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	9
Udhëzime të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë	1
Urdhër i Komisionit të Posaçëm të Apelimit	8
Vendi e të Bordit të Transparencës	24
Vendime të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit	29
Vendime dhe urdhra të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit	5
Kërkesa për shpronësim	82
Vendime dhe kërkesa të gjykatave, për shpallje të zhdukur dhe të vdekur	63
TOTALI	2180

Është realizuar botimi i indeksi vjetor të Fletoreve Zyrtare të vitit 2022 parashikuar në nenin 6 të ligjit nr. 78/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, listimi kronologjik i të gjitha akteve juridike të botuara në serinë e Fletoreve Zyrtare të vitit 2022.


Të gjitha aktet janë botuar brenda afatit 10-ditor, parashikuar në nenin 10 të ligjit nr. nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”.

Tabela 2. Statistika Fletore Zyrtare 2021–2022


Viti	Numra FZ-je të botuar	Numra aktesh të botuara	Numër faqesh
2021	206	2164	21211
2022	179	2180	23335



Grafik 1 - Numra FZ-je të botuar



Grafik 2 - Numra aktesh të botuara



Grafik 3 - Numër faqesh

2. SEKTORI I BOTIMIT TË BULETINIT TË NJOFTIMEVE PUBLIKE

Gjatë vitit 2021, Sektori i Botimit të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare ka realizuar botimin në letër dhe variant elektronik të **40** numrave të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare.

Të gjitha aktet janë botuar brenda afatit 10-ditor të parashikuar në nenin 10, të ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”.

Janë botuar **94** akte, numri total i faqeve është **436**, me tirazh 500 copë për çdo numër Buletini.

Më poshtë janë të listuara në mënyrë të detajuar të gjitha institucionet që kanë dërguar aktet për botim në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe numri i akteve për secilin institucion.

Tabela 3. Institucionet të cilat kanë botuar akte në BNJZ 2022

Nr.	Institucioni	Numri i njoftimeve/kërkesave
1	Agjencia e Trajtimit të Pronave	1
2	Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër	1
3	Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë	2
4	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas	1
5	Institucioni i Presidentit të Republikës	1
6	Kolegji i Posaçëm i Apelit	6
7	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	21
8	Kryeministria	1
9	Ministria e Arsimit dhe Sportit	10
10	Ministria e Drejtësisë	1
11	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	33
12	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	2
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	12
14	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2
TOTALI		94


Tabela 4. Përmbledhëse e botimeve të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare 2022

Nr. i Buletinit	Nr. i akteve të botuara në Buletin	Nr. i faqeve	Data e botimit
-----------------	------------------------------------	--------------	----------------


Buletin nr. 1	1	8	10.1.2022
Buletin nr. 2	4	12	19.1.2022
Buletin nr. 3	2	12	24.1.2022
Buletin nr. 4	2	12	31.1.2022
Buletin nr. 5	1	4	7.2.2022
Buletin nr. 6	2	12	14.2.2022
Buletin nr. 7	3	32	21.2.2022
Buletin nr. 8	3	16	28.2.2022
Buletin nr. 9	1	8	8.3.2022
Buletin nr. 10	4	8	23.3.2022
Buletin nr. 11	2	8	29.3.2022
Buletin nr. 12	2	32	4.4.2022
Buletin nr. 13	2	8	19.4.2022
Buletin nr. 14	2	12	26.4.2022
Buletin nr. 15	5	40	4.5.2022
Buletin nr. 16	1	4	9.5.2022
Buletin nr. 17	1	4	16.5.2022
Buletin nr. 18	1	4	23.5.2022
Buletin nr. 19	2	8	30.5.2022
Buletin nr. 20	3	8	6.6.2022
Buletin nr. 21	1	4	7.6.2022
Buletin nr. 22	5	32	13.6.2022
Buletin nr. 23	1	4	27.6.2022
Buletin nr. 24	3	8	5.7.2022
Buletin nr. 25	1	4	12.7.2022
Buletin nr. 26	8	12	8.8.2022
Buletin nr. 27	1	8	22.8.2022
Buletin nr. 28	2	8	20.9.2022
Buletin nr. 29	4	8	3.10.2022
Buletin nr. 30	2	8	10.10.2022
Buletin nr. 31	3	12	17.10.2022
Buletin nr. 32	3	8	24.10.2022
Buletin nr. 33	3	8	8.11.2022
Buletin nr. 34	2	8	14.11.2022
Buletin nr. 35	1	8	21.11.2022
Buletin nr. 36	2	8	30.11.2022
Buletin nr. 37	4	8	5.12.2022
Buletin nr. 38	2	8	12.12.2022
Buletin nr. 39	1	8	19.12.2022
Buletin nr. 40	1	12	27.12.2022
TOTALI	94	436	

Tabela 5. Statistika BNJZ 2021–2022


Viti	Numra Buletini të botuara	Numër aktesh të botuara	Numër faqesh
2021	34	61	336
2022	40	94	436



Grafik 4 - Numra Buletini të botuara



Grafik 5 - Numër aktesh të botuara



Grafik 6 - Numër faqesh

3. SEKTORI I ARKIVIT ELEKTRONIK

Sektori i Arkivit Elektronik gjatë periudhës janar–dhjetor 2022 ka realizuar proceset e punës, si më poshtë:
Për periudhën 5.1.2022–30.12.2022 Qendra e Botimeve Zyrtare ka realizuar dhe publikuar në variant elektronik:

- 179 numra të Fletoreve Zyrtare;
- 40 numra të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare;
- Publikimin e 2180 akteve të botueshme individuale (akte të botueshme);
- 8 tituj botimesh:
 - Kodi Penal;
 - Kodi Civil;
 - Kodi i Procedurës Civile
 - Kodi i Procedurës Penale;
 - Përmbledhëse Legjislacioni për Vendimet GJEDNJ, vëllimi I;
 - Përmbledhëse Legjislacioni për Vendimet GJEDNJ, vëllimi II;
 - Përmbledhëse Legjislacioni për Vendimet GJEDNJ, vëllimi III;
 - Përmbledhëse Legjislacioni për Kadastrën;
 - Përmbledhëse Legjislacioni për Noterinë;
 - Përmbledhëse Legjislacioni për Vendimet Unifikuese të Gjykatës së Lartë 2014–2022.

Tabela 6. Përmbledhëse e botimeve të Qendrës së Botimeve Zyrtare 2021–2022

Nr.	Lloji i akteve	Numri i botimeve
1	Fletorja Zyrtare	179
2	Buletini i Njoftimeve Zyrtare	40
3	Akte të botueshme	2180
4	Kode, përmbledhëse legjislacioni	8 (4 kode dhe 4 përmbledhëse)

1. Mirëmbajtja e infrastrukturës TIK të institucionit

Infrastruktura e Teknologjisë së Informacioni dhe e Komunikimit (TIK) është një komponent shumë i rëndësishëm për institucionin, por në këtë periudhë ka pasur problematika të ardhura si pasojë e mungesës së stafit IT të atashuar pranë QZB-së e më pas si pasojë edhe e sulmit kibernetik. Këto kanë sjellë probleme në disa aspekte të punës, si me serverin, pajisjet kompjuterike, rrjetin e internetit, aksesin me *e-mail*-in zyrtar, me folderat e brendshëm dhe problematika në disa raste në publikimin e akteve dhe të Fletores Zyrtare.


2. Evidentimi dhe përditësimi i të gjitha akteve ligjore të cilat kanë pësuar ndryshime

Procesi i përditësimit është proces i vazhdueshëm dhe, si i tillë, ai është kryer gjatë gjithë periudhës së mësipërme. Punonjësit e ngarkuar me kryerjen e këtij procesi, pas publikimit të çdo Fletoreje Zyrtare kryejnë kontrollin dhe evidentimin e akteve që duhen përditësuar dhe më pas i përditësojnë ato.

Gjatë kësaj periudhe janë përditësuar **647** akte, si ligje, vendime të Këshillit të Ministrave dhe akte të tjera, si: urdhra, udhëzime të ministrave etj., nga të cilat **146** janë akte të shfuqizuara. Në përfundim të procesit të përditësimit, versionet e përditësuara të akteve janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të institucionit.

Tabela 7. Lloji i përditësimeve në Sektorin e Arkivit Elektronik 2021–2022

Nr.	Lloji i përditësimit	Numri i akteve të përditësuara
1	Ndryshim	477
2	Shfuqizim	146
3	Korrigjues	24
	TOTAL	647



Grafik 7 - Lloji i përditësimeve në Sektorin e Arkivit Elektronik 2021–2022

3. Krijimi dhe mirëmbajtja e Regjistrit Shtetëror të Akteve (shkresor dhe elektronik)

Regjistri Elektronik i Akteve krijohet dhe mirëmbahet nga Sektori i Arkivit Elektronik. Pas publikimit të çdo Fletoreje Zyrtare, punonjësi, të cilit i është ngarkuar detyra e regjistrimit dhe e mirëmbajtjes së regjistrit, kryen regjistrimin e çdo akti në këtë regjister.

Për vitin 2022 deri tani janë regjistruar gjithsej **2180 akte të botueshme**.

4. Shërbimi i informacionit ligjor për publikun

Sektori i Arkivit Elektronik të akteve ka dy specialistë për Shërbimin e Informacionit Ligjor për Publikun, njëri prej të cilëve ka edhe funksionin e koordinatorit për të Drejtën e Informimit të Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Në përmbushje të detyrës së shërbimit të Informacionit Ligjor për Publikun, gjatë periudhës 1.1.2022–31.12.2022 janë realizuar detyrat e mëposhtme:

1. Mbajtja e korrespondencës me institucionet shtetërore, në lidhje me informacionet e publikimit të akteve në Fletoren Zyrtare dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.


2. Ndjekja e punës me kërkesat e qytetarëve për informacione të ndryshme ligjore dhe kthimi i përgjigjeve brenda afateve ligjore, gjithsej **100 përgjigje të kërkesave me e-mail dhe 36 në formë shkresore**.

3. Pritja e publikut në mjediset e Qendrës së Botimeve Zyrtare: Janë trajtuar **gjithsej 96 raste** të kërkesave të ndryshme për informacion për akte ligjore.

Këtë vit duke qënë se shumica e shërbimeve kanë kaluar online edhe sa i takon këtij sektori ka patur ndryshime në sensin që edhe publiku është orientuar që në vijim ti drejtojë kërkesat për informacion nëpërmjet e mailit.

Tabela 8. Kërkesa të publikut 2021–2022

Nr.	Emërtimi	Numri
1	Kërkesa me <i>email</i>	100
2	Kërkesa në formë shkresore	36
3	Kërkesa publiku në QBZ	96
4	Çështje gjyqësore	2
5	Procedura prokurimi	18



Grafik 8 - Kërkesa të publikut 2021–2022

4. Ndjekja e proceseve gjyqësore të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe përgatitja e të gjitha akteve të nevojshme për proceset gjyqësore: Janë **2 raste** brenda kësaj periudhe (1.1.2022–30.12.2022), një i përfunduar dhe tjetri në proces, si më poshtë.

Tabela 9. Proceset gjyqësore 2021–2022

Paditës/ I paditur	Objekti	Nr. akti/ data	Nr. vendimi/ GJSH I	Nr. vendimi/ GJA	Nr. vendimi/ GJL	Juristi	Dispozitivi
1. Pala paditëse: Shoqëria Tregtare “Classic” sh.p.k., me seli në Kashar, Autostrada Tiranë–Durrës, km 1. Pala e paditur: Qendra e Botimeve Zyrtare.	Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit Shoqëria Tregtare “Classic” shumën prej 25.200 (njëzet e pesë mijë e dyqind) lekësh, si detyrim i papaguar nga faturat tatimore të shitjes.		Nr. 3430, datë 21.6.2022			Enida Plaku Vilma Belishta	Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

2. Pala paditëse: Qendra e Botimeve Zyrtare . Pala e paditur: Shogëria Përmbarimore “Besa” sh.p.k. me NIPT: L62107009Q, me adresë: Rr. “Frederik Shiroka” kulla nr. 3, kati i 2-të, zyra 7, Tiranë.	Kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, të urdhrit nr. 104/13, datë 21.9.2022, “Për vendosjen e sekuestros konservative”. Pezullimin e veprimeve përmbarimore.		Në proces gjykimi			Enida Plaku Vilma Belishta	Kundërshtimin e veprimeve përmbarimore për vendosjen e sekuestros konservative, për titullin ekzekutiv “Vendim nr. 2641, datë 9.7.2018”)

5. Prokurimi publik

Gjatë periudhës 5.1.2022–30.12.2022 janë realizuar 17 procedura prokurimi nga 18 të parashikuara. Ka mbetur vetëm një procedure e parealizuar, sipas treguesit në tabelën bashkëlidhur:

Tabela 10. Prokurimet publike në QBZ 2021–2022

Nr.	Procedura e prokurimit	Lloji i procedurës	Procedura realizuara	të	Procedura parealizuar	të
1	Blerje materialesh ndihmëse për shtypshkronjën e Qendrës së Botimeve Zyrtare për vitin 2022	Blerje me vlerë të vogël	+			
2	Kolaudim/rimbushje fikësi zjarri për vitin 2022	Blerje nën vlerën 100 000 lekë	+			
3	Rikonstruksion godine 2022	procedure e hapur e thjeshtuar	+			
4	Blerje materialesh pastrimi 2022	Blerje nën vlerën 100 000 lekë	+			
5	Botime speciale dhe shtypje kapakësh për vitin 2022	Blerje me vlerë të vogël	+			
6	Bojar printeri	Blerje nën vlerën 100 000 lekë	+			
7	Kancelari, letër 2022	Minikontratë	+			
8	Mirëmbajtje gjeneratori për vitin 2022	Blerje nën vlerën 100 000 lekë	+			
9	Riparim dhe mirëmbajtje sistemi kondicionimi për vitin 2022	Blerje me vlerë të vogël	+			
10	Mirëmbajtje Alpha Buxhetor	Blerje nën vlerën 100 000 lekë	+			
11	Blerje biletash transporti 2022	Blerje me vlerë të	+			

		vogël		
12	Mirëmbajtje, moduli i fiskalizimit 2022	Blerje nën vlerën 100 000 lekë		+
13	Mirëmbajtje ndërtesë, rrjeti elektrik dhe hidraulik për vitin 2022	Blerje me vlerë të vogël	+	
14	Mirëmbajtje printeri Xerox	Procedurë e hapur e thjeshtuar	+	
15	Mirëmbajtje sistemi kompjuterik për vitin 2022	Blerje me vlerë të vogël	+	
17	Blerje kutish dhe dosjesh për ruajtje të përhershme	Minikontratë	+	
18	Blerje pajisjesh elektronike/informatike	Blerje me vlerë të vogël	+	

4. SEKTORI I FINANCËS

Shpenzime për vitin 2022

Në zbatim të ligjit 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, Qendrës së Botimeve Zyrtare i janë akorduar fonde buxhetore në masën 45 522 000 lekë, nga 50 777 750 lekë në vitin 2021. Realizimi i buxhetit është kryer në masë 92.4%, nga 78.6% në 2021.

Të ardhurat për vitin 2022

Gjatë vitit 2022 Qendra e Botimeve Zyrtare ka realizuar të ardhura nga shitjet, abonimet dhe shërbimet e tjera të ofruara (konfirmim kopje akti) në vlerën prej 1,757,200 lekë, nga 1 707 405 lekë në 2021.

5. SEKTORI I SHTYPSHKRONJËS

Spektori i Shtypshkronjës ka realizuar detyrat e mëposhtme:

Gjatë vitit 2022 ka shtypur gjithsej:

- 179 fletore zyrtare
- 40 buletine zyrtare (me tirazh 500 kopje).

Spektori i shtypshkronjës ka arritur të shtyp, brenda afateve, të gjitha fletoret dhe buletinet e publikuara nga QBZ-ja, pavarësisht nga vështirësitë që sektori ka hasur për shkak të vonësës në lidhjen e kontratave me kompanitë që ofrojnë shërbime mbështetëse ndaj këtij sektori, siç janë: lastrat e zhvilluara, botimet në palë të treta, mirëmbajtja e printerit Xerox D136 etj.

Gjatë kësaj periudhe, për përmbushjen e detyrimeve brenda afateve ligjore, sektori i shtypshkronjës ka shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e veta teknike dhe njerëzore.

Gjatë vitit 2022, sektori shtypshkronjës ka pasur plan botimi 8 tituj botimesh:

- Kodi Penal;
- Kodi Civil;
- Kodi i Procedurës Civile
- Kodi i Procedurës Penale;
- Përmbledhëse Legjislacioni për Vendimet GJEDNJ, vëllimi I;
- Përmbledhëse Legjislacioni për Vendimet GJEDNJ, vëllimi II;
- Përmbledhëse Legjislacioni për Vendimet GJEDNJ, vëllimi III;
- Përmbledhëse Legjislacioni për Kadastrën;
- Përmbledhëse Legjislacioni për Noterinë;
- Përmbledhëse Legjislacioni për Vendimet Unifikuese të Gjykatës së Lartë 2014–2022.

RAPORT MONITORIMI
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT TË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE
JANAR –DHJETOR 2022

Përmbledhje Ekzekutive

Qasja vlerësuese

**Metodologjia e monitorimit Gjetjet
e raportit**

**Objektivat e parashikuar ne Planin e Integritetit Konkluzione
dhe rekomandime**

Hapa të tjera

Aneks

QBZ	Qendra e Botimeve Zyrtare
MD	Ministria e Drejtësisë
MVRI	Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit
PI	Plan Integriteti
PT	Programi i Transparencës
SNKK	Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Përballja efektive me korrupsionin për Qendrën e Botimeve Zyrtare është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjen, si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Qendra e Botimeve Zyrtare ka përgjegjësinë kryesore të botimit dhe publikimit të akteve të botueshme të RSH-së brenda afateve ligjore. Duke patur një rol të rëndësishëm në këtë fushë, jemi të vetëdijshëm se duhet të jemi ndër të parët që të japim shembullin për t'i shërbyer interesit publik, në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë, me vlera etike dhe të bazuara në ligj. Plan i integritetit është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit proaktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion.

Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative. Vendosja e planit të integritetit dhe siguri i zbatimit të tij përbën një *approach* që garanton masat antikorrupsion dhe një mundësi të shtuar të suksesit të zbatimit të tyre.

Qendra e Botimeve Zyrtare, është kontribuese për objektivat A.8 dhe A.9 të SNKK-së, që materializojnë forcimin e integritetit në administratën publike.

Në zbatim të këtyre objektivëve, gjatë vitit 2021, Qendra e Botimeve Zyrtare hartoi dhe miratoi Planin e Integritetit i cili ka karakter parandalues në luftën kundër korrupsionit. Ky plan është hartuar duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 07.10.2021.

Plan i Integritetit i Qendrës së Botimeve Zyrtare është një instrument i luftës kundër korrupsionit, i cili ka të parashikuar masa të identifikuara në 6 fusha të përgjegjësisë institucionale të QBZ-së. Plan i Integritetit përmban gjithsej 16 masa të karakterit rregullator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të

evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë sektorët e Qendrës së Botimeve Zyrtare si dhe grupe pune. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti është deri në vitin 2023.

Referuar miratimit të Instrumentit e Monitorimit të Planit të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, nga Ministria e Drejtësisë, Qendra e Botimeve Zyrtare ka hartuar këtë raport monitorimi mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.


Raporti jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të Qendrës së Botimeve Zyrtare , për vitin 2022, për statusin e zbatimit të tyre, informacionin për buxhetin, përmban të dhëna për veprimtarinë operationale të njësive (sektoreve) të brendshme kontribuuese, referuar hartimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator të brendshëm rregullator, burimeve njerëzore dhe profesionale si dhe transparencën dhe komunikimin me grupet e interesuara.

Për vitin 2022, Plani i Integritetit ka të parashikuar për zbatim 16 masa/aktivitete, të shpërndara në 6 objektiva, përkatësisht:

1. Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit;
2. Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore;
3. Parandalimi i konfliktit të interesit;
4. Forcimi i integritetit në sistemin e prokurimeve;
5. Sigurimi i nivelit më të lartë të transparencës me publikun.
6. Mirëadministrimi me efikasitet të fondeve buxhetore dhe kontrolli

Këto objektiva strategjike bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si edhe me paketën e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin publik. Këto objektiva i kane sherbyer punes së institucionit përgjatë periudhës së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat dhe nëpunësit përgjegjës.

Statusi i zbatimit të Planit të Integritetit



Nga monitorimi rezulton se në totalin prej 16 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2022, rezulton se: janë zbatuar te gjitha masat masa/aktivitetet e parashikuara.

Ky raport monitorimi evidenton rritjen dhe forcimin e transparencës së institucionit në publikimin dhe njoftimin e kuadrit ligjor, konsultimin publik, raporteve të performancës dhe ato të menaxhimit

Qasja vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Qendrës së Botimeve Zyrtare përmban një analizë të përgjithshme të kuadrit rregullator mbi aspekte të integritetit në QBZ-së, të performancës institucionale për ti rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështje të transparencës institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të 4 sektorëve në Qendrën e Botimeve Zyrtare , të një grupi të brendshëm pune dhe të koordinatorit të së drejtës së informimit, një funksion i

përcaktuar në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit. Raporti përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasiore të kontributit të tyre.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinator i Integritetit të Qendrës Së Botimeve Zyrtare , në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinator i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme.

Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuuese në këtë raport, të cilat janë:

- Sektori i Arkivës Elektronike të akteve ;
- Sektori i Financës ;
- Sektori i Burimeve Njerëzore.


Mbledhja e informacionit nga këto njësi është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secila njësi ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashikuar për zbatim për periudhën; akte dhe dokumenta të hartuara (verifikueshmëria) e të dhënave; të dhëna për buxhetin; rekomandime dhe konkluzione.

Gjetjet e Raportit

Referuar objektivave për vitin 2022 **në fushën e Menaxhimit të burimeve njerëzore** janë realizuar aktivitetet e parashikuara:

1. Krijimi dhe administrimi i dosjeve të personelit për cdo te punësuar
2. Ngritja dhe funksionimi i sistemit te vleresimit te rezultateve ne pune
3. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i planit per kualifikimin dhe trajnimin e administrates

4. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullores se brendshme te administrates dhe Kodit te Etkes se institucionit
5. Hartimi dhe miratimi i dokumentit te politikave per mbrojtjen e te dhenave personale
6. Ngritja dhe funksionimi i autoritetit pergjegjes per parandalimin e konfliktit te interesave ne institucion
7. Krijimi dhe administrimi i regjistrit te dhuratave.




Në fushën e Parandalimit të konfliktit të interesit dhe Forcimit të integritetit në sistemin e prokurimeve janë realizuar aktivitetet e parashikuara:

1. Ofrimi i këshillimit nga njësia e Burimeve Njerëzore për punonjësit që gjenden në situatën e konfliktit të interesit.
2. Monitorimi me fokus të veçantë në fushën e prokurimeve publike, për të ulur riskun e favorizimit të një subjekti.

Sa më sipër është kryer rregullisht plotësimi i deklaratës së konfliktit të interesit nga ana e punonjësve në të gjitha rastet e procedura të prokurimit të kryera.

Zbatimi i Objektivit 2 & 3




Në fushën e Transparencës në kuadër të Programit të transparencës, janë bërë hapa të rëndësishëm përpara për zgjerimin e rrezes së transparencës ndaj publikut në aspekte të rëndësishme të operimit të punëve dhe shërbimeve të institucioneve shtetërore.

Për këtë qëllim është vënë në shërbim të publikut të gjerë informacion i detajuar për aktivitetin e përditshëm institucional të QBZ-së, në web, në faqen online , respektivisht në fusha si vijon:

- Rreth autoritetit, ku pasqyrohen struktura organizative, funksione, organigrama, pagat, procedura për bërjen e kërkesave dhe ankesave etj.
- E drejta për tu informuar dhe regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, si aktet e komunikimit me publikun dhe transparenca mbi natyrën e kërkesave për informacion të QBZ-së.
- Informacion mbi buxhetin, të dhëna për prokurimet, raporte, strategji etj.
- Arkiva, sistemi i ruajtjes së dokumentacionit , Fletore Zyrtare të RSH-së, mekanizma etj.


Ky program mundëson akses të gjithanshëm dhe të përmbledhur për të gjithë aktivitetin e QBZ-së , në shërbim të publikut.



Në fushën e menaxhimit financiar janë realizuar me efikasitet fondet buxhetore dhe aktivitetet/masat e parashikuara:

1. Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i programit buxhetor afatmesem
2. Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i buxhetor vjetor të QBZ
3. Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i rregullave dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve
4. Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i normave dhe rregullave ruajtjen, dhe administrimin e dokumentave financiare
5. Përgatitja, miratimi brenda 3 muajve të para të vitit pasardhës të raporteve financiare mbi ekzistencën e realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor dhe planit të punës.

Zbatimi i Objektivit 5



Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar-dhjetor 2022*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që sektorët kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezulton se:

- Qendra e Botimeve Zyrtare ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit.
- Garantimi i transparencës së plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e QBZ-së për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit www.qbz.gov.al.

Hapa të tjera

- Të vijohet me zbatimin e parashikimeve në planin e veprimit;
- Të vijohet me raportimet periodike.

Aneks

- Aneksi i raportimit të informacionit nga njësitë kontribuese